PKR. nr.5/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti për Krime të Rënda, gjyqtari Gëzim Pozhegu, kryetari i trupit gjykues, me zyrtaren ligjore Arbënore Basha, në lëndën penale kundër të akuzuarit G.I., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1. të KPRK-së, duke vendosur për pranimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë sipas propozimit të Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë PP/I-nr.89/2018 të datës 30.01.2019, në seancën e shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur në pranin e Prokurorit të shtetit të Prokurorisë Themelore –Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë Ali Uka, të akuzuarit G.I., mbrojtësit avokat P.K. nga Gjakova, me datë 25.06.2019, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 28.06.2019, përpiloi këtë :

A K T GJ Y K I M

I akuzuari **G.I.,** i biri i Sh., nënës Z., e gjinisë K., data e lindjes..., në Gjakovë, Komuna e Gjakovës, nr. personal ..., ka të kryer Fakultetin e Veterinarisë- Drejtor –pronar i Ambulancës private Veterinare NSH "G-V.", i martuar, at i 2 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ka keqpërdorur detyrën zyrtare, në atë mënyrë që i pandehuri G.I. duke qenë në pozitën e drejtorit në Ambulancën Veterinare NSH"G-V.", në atë mënyrë që me rastin e matrikulimit të viqave të rinjë për vitin 2018 për fshatrat M., J., Sh., B., H., D. dhe P. në sistemin AUV-it ka raportuar se ka kryer matrikulimin e 1.042 krerë viqa të rinjë, gjersa gjendja reale në teren është vërtetuar se ka bërë matrikulimin e 121 krerë viqa e që ka mospërputhje për 921 viqa e që realisht janë verifikuar gjithsejtë 115 fermerë ashtu që me këto veprime i ka shkaktuar dëm Agjensionit të Ushqimit dhe Veterinarisë të Kosovës rreth 2.210.40 euro dhe se sipas Drejtorit të AUV-it një matrikulë ka kushtuar 0.60 euro gjera për një matrikulim ka kushtuar 1.80 euro.

- **me çka ka kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1. të KPRK-së.**

Gjykata në bazë të nenit 6, 7, 17, 41, 45, 47, 73, 74, 75, 76 par. 1 nën par. 1.5, 422 par. 1 dhe nenit 233, 365, 450 dhe 463 të KPP-së, e:

GJYKON

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit dhe sipas marrëveshjes së arritur e bazuar në nenin 47 të KPRK-së, zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 3.000,oo €, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, i njëjti do ta vuaj dënimin e shqiptuar me burgim **në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve**.

Detyrohet i akuzuari që në afatin prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të ja kompensoi të dëmtuarit dëmin në vlerë prej 2.210.40 €.

Në kuptim të nenit 450 parg.4 të KPPK-së, i akuzuari obligohet që të që të paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej njëzetepesë (25) €, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej njëzetepesë (25) € si dhe shumën prej pesëdhjetë (50) € në emër të kompensimit të viktimave të krimit, konform neni 39 par.3, nënpar.3.2 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e cila shumë duhet paguar në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda me aktakuzën PP/I. nr. 89/2018 të datës 31.01.2019 ka akuzuar G.I., për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1. të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ku prezentë kanë qenë prokurori Ali Uka, i akuzuari G.I. dhe mbrojtësi i tij P.K. avokat në Gjakovë.

Prokurori Ali Uka ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë marrëveshjes së arritur dhe kushteve të propozuara me marrëveshje, ashtu që i ka propozuar gjykatës që të njëjtën marrëveshje ta aprovoi si të bazuar, pasi kjo marrëveshje është bërë me vullnetin e të akuzuarit G.I. dhe është në pajtueshmëri me provat e bashkëngjitura aktakuzës.

E dëmtuara përmes e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës, Avokati Shtetëror A.Z. me parashtresën e datë 28.05.2019 ka deklaruar se i bashkëngjitet ndjekjes penale si dhe ka kërkuar që të bëhet kompensimi i dëmit të shkaktuar në vlerë prej 2.210.40 € siç është paraparë me Aktakuzën PP/I.nr.89/2018 datës 31.01.2019 në bazë të komunikimit përmes postës elektronike me të dëmtuarën.

Mbrojtësi i të akuzuarit G.I., avokati P.K. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë marrëveshjes nga se në këtë marrëveshje janë shprehur elementet konform vullnetit të palës dhe prokurorit.

I akuzuarit G.I. ka theksuar se mbetet pranë marrëveshjes në formë të shkruar, premton se më nuk do të kryen vepër penale si dhe do të ja kompensoi dëmin e shkaktuar të dëmtuarës.

Gjykata pas dëgjimit të pretendimeve të prokurorit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, lidhur me marrëveshjen për pranim të fajësisë, ka konstatuar se i akuzuarit G.I. e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë sipas marrëveshjes, marrëveshja është bërë në baza vullnetare pas konsultimeve të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, i akuzuari nuk ka qenë i shtrënguar apo i detyruar në lidhjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, pranimin e fajësisë e mbështet në faktet dhe provat që i janë bashkëngjitur aktakuzës, si dhe nuk ekziston asnjëra nga rrethanat për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale të parapara me nenin 253 par. 1 dhe 2 të KPP-së, andaj gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjore dhe është e bazuar në nenin 233 par. 21 të KPP-së dhe gjykata ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

Gjatë seancës për caktimin e dënimit prokurori Ali Uka ka deklaruar se mbetet pranë dënimit të propozuar me marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj, i cili dënim do të zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 2.500,oo-3.000,oo €. I pandehuri obligohet që Agjensionit të Ushqimit dhe Veternarisë (AUV) në Prishtinë t ‘ ia kompensojë dëmin e shkaktuar në të holla në shumë prej 2.210.40 €.

I dëmtuari Përfaqësuesi i autorizuar i i Agjensionit të Ushqimit dhe Veterenarisë, me anë të parashtresës e ka njoftuar gjykatën se i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe kërkon kompensimin e dëmit të shkaktuar në vlerë prej 2.210,40 €.

Mbrojtësi i të akuzuarit, avokati G.I. ka theksuar se pajtohet me marrëveshjen e arritur edhe sa i përket dënimit të propozuar.

I akuzuari G.I. ka deklaruar se mbetet pranë marrëveshjes dhe deklarimeve të mbrojtësit të tij të dhënë gjatë kësaj seance, si dhe thekson se do t' ia kompensoi dëmin e shkaktuar të dëmtuarit në vlerë prej 2.210,40 €.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe llojit të tij, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale, në mënyrën, kohën dhe vendin të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit nuk ka gjetur rrethana rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka marr parasysh pranimin e fajësisë, pendimin e tij, sjelljen korrekte gjatë seancës, është hera e parë që paraqitet pranë organeve të ndjekjes, e të cilat rrethana kanë ndikuar që të aplikohen dispozitat e zbutjes së dënimit bazuar në nenin 76 par. 1 nën par. 1.5 të KPRK-së, e të akuzuarit G.I. ti shqiptohet dënimi i paraparë me marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej 3.000,oo €, me bindjen e plotë se ky dënim është në harmoni me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi që i akuzuari të obligohet që të dëmtuari të ja kompensoi dëmin e shkaktuar është marrë bazuar në neni 463 par. 1 dhe 2 të KPP-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marr bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
PKR. nr. 5/19 datë 25.06.2019

Zyrtarja ligjore,
Arbënore Basha

Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari,
Gëzim Pozhegu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes të kësaj gjykate.